

## KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

**Leonard Dauti**

### **Argumentimi shkencor si prurje në veprën “Burimi dhe formimi i dëshirores së shqipes” (2021), të autorit Ethem Likaj**

Periodha e gjysmës së dytë të shekullit XX deri në fillimet e shekullit XXI ka qenë mjaft e suksesshme për sa i përket prurjeve në lëmin e gjuhësisë historike. Mund të themi pa mëdyshje se u arrit që qendra e këtyre studimeve të zhvendosej nga qendrat shkencore jashtë vendit, të interesuara për albanologjinë, brenda hapësirës shqiptare, pasi qenë studiuesit shqiptarë ata që e mbajtën peshën kryesore, si për gjerësinë e shtrirjes ashtu edhe për seriozitetin dhe sistematicitetin e studimeve në këtë fushë. Në ditët e sotme duket se kjo fushë studimesh po gjen gjithmonë e më pak ndjekës ndër studiuesit shqiptarë. Me përjashtim të pak gjuhëtarëve, tashmë të afirmuar, nuk duket të ketë një brez të ri që të vazhdojë traditën e krijuar. Qendra e studimeve historike për gjuhën shqipe po zhvendoset, në mos është zhvendosur, përsëri jashtë trojeve shqiptare, ashtu sikurse ishte në fillimin e shekullit XX. Kjo nuk besoj se lidhet vetëm me vështirësitë specifike që paraqet kjo fushë e dijes gjuhësore, por edhe me vëmendjen dhe planifikimin e strategjisë së kërkimit shkencor në institucionet përkatëse, departamentet e gjuhësisë apo Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Parë në këtë kontekst, vepra e akademikut Ethem Likaj, “Burimi dhe formimi i dëshirores së shqipes”, të cilën po e paraqesim si një prurje shkencore me një objekt studimi me tepër interes për historinë e shqipes, duket se vjen pikërisht në kohën e duhur. Unë vetë dëshiroj ta shikoj edhe si një kumt për tërheqjen dhe rikthimin e vëmendjes së studiuesve, por sidomos të drejtuesve të institucioneve të kërkimit shkencor gjuhësor, ndaj moslënies pas dore të kësaj fushe tejet të rëndësishme të studimeve albanologjike. Le të shpresojmë që ky “nëntekst i veprës” nuk do të kalojë pa lënë gjurmë ...

Gjuhëtari i mirënjohur, akademik Ethem Likaj, ka një përvojë mjaft të pasur dhe të gjatë në studimet historike, kryesisht në fushën e gramatikës historike të gjuhës shqipe. Fryt i veprimtarisë së tij shkencore janë një sërë veprash. Po përmend dy disertacionet: “Roli i analogjisë në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe” (1978) – për gradën “Kandidat i Shkencave Filologjike” dhe “Format analitike dhe analitizmi në gjuhën shqipe” (1988) – për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, të cilat mund të shihen si fillesa embrionale e dy veprave të mëvonshme: “Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe” (1984), “Format analitike në gjuhën shqipe” (1997). Vepra të tjera të autorit janë: “Eptimi emëror indoevropian” (1999), “Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe: morfologji historike” (2003), “Fleksioni indoevropian” (2005), “Morfologji e shqipes standarde” me bashkautor (2010), “Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes” (2015), “Ndikime në fjalëformat e shqipes” (2019), pa përmendur një numër të shumtë artikujsh, kryesisht në fushën e morfologjisë së gjuhës shqipe.

Kur vlerësojmë një punim në fushën e gjuhësisë, aq më tepër një studim që objekt të vetin ka historinë e një dukurie të caktuar gjuhësore, siç është ajo e origjinës së dëshirores së shqipes në studimin në fjalë, nuk mund të nisemi kurrsesi nga vërtetësia e përfundimit të arritur. Në fushën e studimeve gjuhësore risitë dhe të rejtat shkencore duan kohën e vet për t’u pranuar. Kjo lidhet jo vetëm me atë që theksonte Riza, se filologët “janë grindavecë prej natyre” dhe se “në botën e pluhurosur të fjalëqëronjësvet” nuk mund të ndodhë mrekullia e rënies në një mendje, por me vetë natyrën e dijes dhe të vërtetës shkencore, e cila zhvillohet duke tejkaluar e mohuar vetveten.

Historia e kërkimit shkencor na ka treguar se përfundimet e çdo punimi shkencor janë vetëm një mundësi për të qenë e vërtetë. Dhe shpesh këto të vërteta janë tejkaluar nga brezat e mëvonshëm të gjuhëtarëve. Dialektika e procesit njohës është një përsëritje e këtij fati të dhimbshëm. Sado të mëdha të kenë qenë arritjet në një periudhë të caktuar të mendimit shkencor, ndryshe nga fusha e artit, ku një vepër e arrirë artistike është unike dhe e tillë mbetet në përjetësi, veprat shkencore, përgjithësisht, kanë pasur gjithmonë fatin e paracaktuar për t’u rishikuar dhe tejkaluar nga arritjet e periudhave pasardhëse. Kjo është dialektika e vetë procesi njohës.

Prandaj edhe punimin “Burimi dhe formimi i dëshirores së shqipes” mendoj se duhet ta gjykojmë e vlerësojmë jo në lidhje me atë se sa e vërtetë është ideja që argumenton autori në lidhje me origjinën e dëshirores së shqipes, por në varësi të asaj se sa shkencore është rruga e ndjekur për arritjen tek përfundimi përkatës, sa drejt dhe paanshmërisht janë parashtruar të dhënat gjuhësore, sa objektive është analiza e këtyre të dhënave në përputhje me metodën dhe metodologjinë e ndjekur në punim, sa rreptësisht shkencore janë përgjithësimet dhe përfundimet e arritura kryesisht përmes induksionit, por edhe deduksionit.

Duke qenë një veçanti për shqipen, krahasuar me gjuhët e tjera të familjes indoevropiane, studimi i historisë së formimit të dëshirores përbën një sfidë për studiuesit e gramatikës historike, për shkak të shkallës së lartë të vështirësisë që lidhet me dy faktorë, sipas autorit: (a) me dokumentimin e vonë të gjuhës shqipe dhe (b) me karakterin tepër subjektiv të kategorisë gramatikore të mënyrës. Nisur nga kjo, krejt punimi organizohet rreth një pyetjeje bosht: *A është ajo vazhdim i dëshirores së përbashkët indoevropiane, apo është zhvilluar brenda vetë shqipes?*

Studimi që kemi në dorë është organizuar në shërbim të përgjigjes përkatëse. Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë, nëse dëshirorja e shqipes është vazhdim i dëshirores së përbashkët indoevropiane, domosdoshmëria për ta orientuar lexuesin në periudhën e errët të historisë së formimit të dëshirores së shqipes, ka diktuar parashtrimin e gjendjes së hershme në gjuhët simotra indoevropiane, sidomos të Greqishtes së Vjetër dhe Sanskritishtes, bazuar në të dhënat që ofrojnë studimet historike në këtë fushë. Me një saktësi, qartësi dhe paanshmëri të admirueshme në përshkrim janë pasqyruar temat foljore kohore-mënyrore të indoevropianishtes, mbaresat vetore, struktura eptimore e sistemit foljor indoevropian për mënyrën dëftore, lidhore dhe optativin, tabela e mbaresave vetore për zgjedhimin vepror tematik dhe jotematik për të tashmen dhe të kryerën e thjeshtë, si dhe ato të zgjedhimit mesor për të tashmen dhe të pakryerën. Një vend të veçantë zë përshkrimi dhe analizimi i lidhjeve dhe dallimeve mes lidhore dhe optativit në indoevropianishte dhe në gjuhë të tjera, pasi kjo çështje lidhet drejtpërsëdrejti me parashtrimin e mendimeve të studiuesve të ndryshëm për burimin e dëshirores së shqipes.

Autori bën një parashtrim të saktë dhe të detajuar të mendimeve të studiuesve për origjinën e dëshirores së shqipes, duke filluar me atë të Bopp-it, sipas të cilit “paradigma e dëshirores nuk është tjetër veç paradigma e “aoristit të lidhore”, që përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirores”. Pas përjasjes së paradigmave përkatëse të Bopp-it, theksohet një mendim interesant i Bopp-it, i papërmendur më parë, në lidhje me burimin e përbërësve u-, v-, f- të këtyre paradigmave.

Mendim tjetër është ai i Pedersenit, i cili e sheh origjinën e dëshirores tek një lidhore e aoristit të dëftores, e rindërtuar mbi bazën e së tashmes së lidhore. Ky mendim qëndron në zanafillë të mendimeve të mëvonshme, përfaqësuar kryesisht nga Demiraj, se dëshirorja e shqipes e ka origjinën tek e kryera e thjeshtë e dëftores.

Teza e Meyer-it, se dëshirorja e shqipes rrjedh prej më se të kryerës së lidhore latine më **-vissem**, mbetet një tezë e pambështetur nga asnjë autor.

Përtej kundërgjendjeve të sjella edhe nga autorë të tjerë, si Riza, Demiraj, Topalli e ndonjë tjetër, për tezat kundërthënëse, autori parashtron analizën e vet kritike, e cila, për hir të së vërtetës, nuk ka asnjë pikë takimi me ashpërsinë mohuese të Rizës. Një risi që sjell prof. Ethem Likaj në analizën e

tij ndaj qëndrimeve të mëparshme është rivlerësimi i komponentit semantik, përkatësisht mospërputhja modale dhe kohore mes formave të aoristit të dëftores e më se të kryerës së lidhore dhe dëshirores së tashme. Analiza e gjatë dhe e hollësishme në rrafshin semantik e mospërputhjes mes formave të dëshirores dhe atyre të së kryerës së thjeshtë në ndërtimet e ndryshme sintaksore, i paraprin parashtrimin të idesë së vetë autorit mbi origjinën e dëshirores së shqipes, të cilën ai e shikon brenda konstelacionit të tri mundësive konkurruese:

- Dëshirorja si tematizim i vetës së dytë njëjës i një lidhoreje të hershme;
- Dëshirorja si tematizim i vetës së dytë njëjës i një dëshiroreje të hershme;
- Dëshirorja si tematizim i vetës së dytë njëjës i një lidhoreje të përngjitur.

Kjo është pjesa më interesante e punimit, për nga mënyra e ndërtimit dhe parashtrimin. Në kushtet e mungesës së dëshmive gjuhësore të dokumentuara, autori e ndërton argumentimin e tij, duke u nisur nga koncepti i tematizimit të formave morfologjike, të cilin e shpalos përmes ekzistencës së tij si tematizim i plotë dhe i pjesshëm. Mbi bazën e një procesi faktik morfologjik, të dëshmuar me njaft shembuj nga shqipja, kalon në parashtrimin e mundësisë së tematizimit të një lidhoreje të hershme. Argumentimi të rrugës morfologjike të kristalizimit të kësaj dukurie i vjen në mbështetje edhe tërësia e argumenteve për vjetërsinë e formimit të dëshirores së shqipes. Duket se teza së cilës i mëshon më shumë autori është ajo e origjinës së dëshirores së shqipes te tematizimi i vetës së dytë njëjës të lidhore së tashme. Përmes një shqyrtimi kritik, argumentimi dhe kundërgargumentimi të mendimeve të autorëve të tjerë, në punim sillen përjasje interesante dhe plotësisht bindëse për lidhjen e temës së dëshirores së sotme me atë të një lidhoreje të hershme, si për foljet e rregullta ashtu edhe për ato të parregullta dhe për foljet supletive. Një listë e kënaqshme foljesh që u përkasin modeleve të ndryshme eptimore sjell një mbështetje konkrete për mënyrën e mundshme të përfuturit të dëshirores nga kjo temë e lidhore.

Duhet të kemi parasysh se jemi në kushtet e parashtrimin të një hipoteze dhe të gjitha argumentet që sjell autori janë përzgjedhur në mbështetje të një interpretimi në favor të saj. Por për këtë autori është i ndërgjegjshëm, prandaj në mënyrë të qartë, që në fillim të punimit, thekson se interpretimi i këtushëm është për t'u parë vetëm si një mundësi dhe jo si zgjidhje e pakundërshtueshme.

Nga ana tjetër, në dallim nga autorët pararendës, të cilët nisen nga ngjashmëritë apo përputhjet e sotme, sado të pjesshme, mes formës së dëshirores me formën e të kryerës së thjeshtë të dëftores, apo me aoristin e supozuar të lidhore, dhe mundohen ta mbështesin tezën e tyre për origjinën e dëshirores mbi bazën e zhvillimeve të mundshme morfonologjike, në këtë punim origjina e dëshirores kërkohet të shpjegohet mbi bazën e një modeli të caktuar tematizues, i cili ka një motivim të caktuar semantik, morfologjik dhe

fonetik. Pa hezitim mund të themi se kemi të bëjmë me një përpjekje për shpjegimin e historisë së një dukurie morfologjike të shqipes mbi bazën e një gjedheje kognitive formëformuese. Dhe merita e padiskutueshme e prof. Ethem Likajt qëndron në faktin se te kjo mënyrë përshkrimi e argumentimi e ka çuar analiza e fakteve gjuhësore të shqipes dhe njohja e dinamikës së zhvillimeve të brendshme të sistemit foljor të gjuhës shqipe.

Përtej kontributit të drejtpërdrejtë në lidhje me burimin e dëshirores së shqipes, ky studim shkencor i akademik Ethem Likajt është për t'u vlerësuar edhe në lidhje me disa prurje jo pak të rëndësishme që prekin si brendinë ashtu edhe anën formale të kërkimit shkencor.

Në lidhje me mendimin e përgjithshëm se format e dëshirores janë të ndër-këmbyeshme me format e lidhores, autori tërheq vërejtjen se “megjithëse ky zëvendësim shpesh është i mundshëm, përveçse mbetet formal, si një zëvendësim i pranueshëm nga ana sintaksore, por jo i barasvlershëm nga ana kuptimore modale, sepse format e lidhores nuk e japin të plotë modalitetin e dëshirës.”

Ndonëse nuk është qëllim në vetvete i autorit, në këtë punim gjenden edhe qëndrime për çështje të caktuara teorike e terminologjike, të cilat kanë një vlerë të posaçme edhe për studimet me karakter sinkronik në fushën e morfologjisë së shqipes. Konceptimi i *temës morfologjike* prej autorit, si ajo pjesë e fjalës që përfshin edhe morfemat formëformuese, risjell në qendër të vëmendjes një nga çështjet e morfologjisë sinkronike, atë të dallimit të temës së eptimit nga tema morfologjike.

Objektiviteti, skrupoloziteti dhe paanshmëria në vlerësimin e punës së studiuesve pararendës mishërohet edhe në mosdiferencimin e studiuesve që janë marrë me çështjen përkatëse në të huaj dhe shqiptarë.

